

UDHËZIM
Nr. 374, datë 24.6.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË
SUBJEKTEVE QË KANË NË ADMINISTRIM PASURITË KULTURORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton rregullat për monitorimin dhe vlerësimin periodik nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, të veprimtarisë së subjekteve që kanë në administrim pasurinë kulturore në pronësi shtetërore, sipas nenit 171, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (në vijim, ligji nr. 27/2018).

2. Monitorimi është një proces vlerësimi lidhur me administrimin e pasurisë kulturore publike nga subjekti, i cili realizohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me qëllim dhënien e rekomandimeve për vazhdimin apo ndërprerjen e marrëdhënies juridike me subjektin juridik privat apo publik.

3. Monitorimi ka si qëllim:

a) të ndjekë arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në marrëveshjen apo kontratën e administrimit të pasurisë kulturore, nëpërmjet administrimit më eficient të pasurisë;

b) të evidentojë nëse realizimi i angazhimeve është në përputhje me marrëveshjen apo kontratën e administrimit të pasurisë kulturore.

4. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim që u është dhënë në ligjin nr. 27/2018.

II. RREGULLAT E MONITORIMIT TË SUBJEKTEVE QË KANË NË ADMINISTRIM PASURITË KULTURORE

1. Ky krye përcakton rregullat e monitorimit, për:

a) institucionet publike qendrore ose njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilave u kalon në administrim direkt pasuria kulturore në pronësi shtetërore, në përputhje me pikat 1 dhe 3, të nenit 10, të ligjit nr. 27/2018;

b) subjektet e parashikuara në pikën 3, të nenit 171 dhe në nenin 172, të ligjit nr. 27/2018.

2. Pas nënshkrimit të marrëveshjes apo kontratës së administrimit të pasurisë kulturore, me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, krijohet njësia e monitorimit, me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore në pronësi shtetërore.

3. Në përbërje të njësisë së monitorimit caktohet të paktën një jurist, një ekonomist dhe një ekspert i trashëgimisë kulturore, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturore dhe institucioneve të saj të varësisë, sipas tipologjisë dhe specifikave të pasurisë kulturore që është dhënë në administrim. Kryetari i njësisë së monitorimit përcaktohet në urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në varësi të marrëveshjes apo kontratës së administrimit të pasurisë kulturore, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore mund të caktojë në përbërje të njësisë së monitorimit më shumë se tre përfaqësues të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturore dhe institucioneve të saj të varësisë.

4. Njësia e monitorimit kryen monitorimin dhe vlerësimin e subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore, në përputhje me periudhat e raportimit të përcaktuara në marrëveshjen apo kontratën e administrimit, por në çdo rast, jo më pak se një herë në vit.

5. Njësia e monitorimit i kërkon subjektit administrues raportim mbi veprimtarinë e tij në administrimin e pasurisë kulturore, sipas marrëveshjes apo kontratës së administrimit. Raportimi përfshin informacion, për:

- a) gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore gjatë periudhës objekt monitorimi;
- b) realizimin e planeve vjetore të veprimtarive kulturore;
- c) veprimtarinë e subjektit në administrimin e pasurisë kulturore në bazë të marrëveshjes apo kontratës së dakordësuar për kalimin e pasurisë kulturore në administrim direkt ose indirekt, të shoqëruar nga dokumentacioni përkatës, sipas parashikimeve në marrëveshjen apo kontratën e administrimit;
- ç) burimet njerëzore, kapacitetet teknike dhe financiare për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurisë kulturore;
- d) garantimin e shërbimeve dhe aksesit për publikun;
- dh) zbatimin e planit të menaxhimit të miratuar të pasurisë kulturore të paluajtshme, kur ka një të tillë;
- e) çdo çështje tjetër për të cilat parashikohet detyrimi i subjektit administrues për raportim në marrëveshjen apo kontratën e dhënies në administrim të pasurisë kulturore.

6. Në rastin e raportimit për administrimin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 3, të nenit 171, të ligjit nr. 27/2018, përveç sa përcaktohet në pikën 5, të këtij kreu, subjekti administrues depoziton edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) pasqyrat e të ardhurave nga shitja e biletave ose shërbimeve të tjera të ofruara për publikun ose çdo informacion tjetër ekonomik dhe financiar që lidhet me administrimin e pasurisë;
- b) pasqyrat financiare vjetore;
- c) ecurinë e zbatimit të planit të biznesit;
- ç) planin vjetor për zhvillimin e aktivitetit të administrimit dhe të aktiviteteve të tjera.

7. Njësia e monitorimit ushtron detyrat si më poshtë:

- a) shqyrton raportin e dorëzuar nga subjekti, që përfshin informacionin e përmendur në pikën 5 të këtij kreu, si dhe dokumentacionin sipas pikës 6 të këtij kreu, nëse është rasti;
 - b) vlerëson zbatimin e marrëveshjes apo kontratës për dhënien në administrim të pasurisë kulturore;
 - c) vlerëson zbatimin e planit të menaxhimit të miratuar të pasurisë kulturore, nëse ka një të tillë;
 - ç) vlerëson gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore në administrim të subjektit administrues.
- Në këtë rast, në përbërjen e njësisë së monitorimit, duhet të jenë të paktën tre ekspertë të fushës së trashëgimisë kulturore.

8. Njësia e monitorimit mund të kërkojë informacion apo dokumentacion shtesë lidhur me çështje të caktuara të konstatuara gjatë shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga subjekti administrues, si dhe informacion apo dokumentacion lidhur me kontrollin teknik të kryer sipas nenit 71, të ligjit nr. 27/2018.

9. Njësia e monitorimit ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë në kuadër të procesit të monitorimit. Shkelja e këtij detyrimi sjell përgjegjësi sipas ligjit.

10. Në rast të ushtrimit të kontrollit në përputhje me shkronjën “ç”, të pikës 7, të këtij kreu, njësia e monitorimit plotëson procesverbalin në vend, i cili firmoset nga njësia e monitorimit dhe subjekti administrues. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet subjektit administrues. Nëse nuk është e mundur mbajtja e procesverbalit në ambientet e pasurisë kulturore, ai përfundohet nga njësia e

monitorimit dhe i njoftohet subjektit administrues brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të kontrollit.

11. Njësia e monitorimit përgatit një raport paraprak monitorimi dhe vlerësimi brenda 15 ditëve kalendarike nga raportimi i subjektit administrues ose nga data e kontrollit sipas shkronjës “ç” të pikës 7 të këtij kreu, cilado të ndodhë e fundit. Raporti paraprak i njoftohet subjektit administrues, i cili ka të drejtë të paraqesë observacionet e tij brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e njoftimit të raportit paraprak të monitorimit dhe vlerësimit. Nëse subjekti administrues nuk i paraqet observacionet brenda këtij afati, konsiderohet se ka pranuar konkluzionet e njësisë së monitorimit.

12. Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e observacioneve, njësia e monitorimit harton një raport përfundimtar monitorimi dhe vlerësimi për subjektin që ka në administrim pasurinë kulturore, i cili përfshin:

- a) përshkrim i veprimtarisë së kryer nga subjekti administrues për periudhën objekt monitorimi;
- b) analizë e informacionit dhe çështjeve të raportuara sipas kërkesave të marrëveshjes apo kontratës së administrimit;
- c) vlerësimin e veprimtarisë së subjektit administrues për periudhën objekt monitorimi;
- ç) observacionet e subjektit administrues, nëse ka;
- d) rekomandimet e nevojshme ndaj subjektit administrues për ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

13. Njësia e monitorimit i rekomandon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore ndërprerjen e marrëdhënies juridike me subjektin privat apo publik, kur subjekti administrues ka kryer shkelje të rënda, sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshjen apo kontratën e administrimit.

14. Raporti përfundimtar i monitorimit dhe vlerësimit së bashku me rekomandimet përkatëse i paraqitet ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe KKMPK-së. Një kopje e raportit përfundimtar i dorëzohet edhe subjektit administrues, objekt monitorimi.

15. Në marrëveshjen apo kontratën e lidhur me subjektin administrues parashikohen rregulla më të detajuara për monitorimin dhe vlerësimin e subjekteve administruese të pasurive kulturore. Por, në çdo rast, rregullat e monitorimit dhe vlerësimit nuk mund të jenë më të ulëta sa parashikimet në këtë udhëzim.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara dhe subjektet që kanë në administrim pasuri kulturore në pronësi shtetërore për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti